



# NJOFTIM MBI TE DREJTAT

Dorezuar nje personi te degjuar ne gjendje te lire  
FORMULAR I PERGJITHSHEM

**Informacionet e meposhteme duhet t'ju jepen ne nje gjuhe qe e kuptoni.**

Njoftoheni se po degjoheni pasi egziston kunder jush nje apo disa arsyje te mundshme per te dyshuar se keni kryer apo tentuar te kryeni nje veper.

Keni te drejte te njihni kualifikimin juridik, daten dhe vendin e dyshuar te kryerjes se vepres per te cilen po degjoheni.

**Keni te drejte te largoheni ne çdo moment nga ambjentet ku po degjoheni.**

## **Perverc Kesaj, Njoftoheni Se Keni Te Drejte :**

### **Te beni deklarata, t'i pergjigjeni pyetjeve ose te heshtni**

Pasi te keni dhene identitetin tuaj, keni te drejte, gjate degjimit :

- te beni deklarata,
- t'i pergjigjeni pyetjeve qe ju behen,
- ose te heshtni.

### **Te asistoheni nga nje avokat**

Nese vepra per te cilen po degjoheni eshte nje krim apo nje delikt i ndeshkuar me denim burgimi, ju mund te asistoheni gjate degjimit ose ballafaqimit tuaj.

### **Zgjedhja e avokatit**

Ju mund te kerkoni te asistoheni nga nje avokat qe e zgjidhni vete. Nese nuk jeni ne gjendje te caktoni nje avokat ose nese avokati i zgjedhur nuk mund te kontaktohet, mund te kerkoni qe t'ju caktohet nje avokat nga kryetari i dhomes se avokatise.

Shpenzimet jane ne ngarkimin tuaj perveç rastit kur plotesoni kushtet e perfitimit nga ndihma juridike, te cilat figurojne ne dokumentin shtese, qe ju eshte dorezuar.

### **Asistenca e avokatit**

Avokati mund :

- te bisedoje me ju ne kushte qe garantojne konfidencen e bisedes;
- dhe te asistojte gjate degjimeve dhe ballafaqimeve tuaja.

Ju mund te pranoni te vazhdoni degjimin tuaj jashte pranise se avokatit tuaj.

### **Te asistoheni nga nje perkthyes**

Nese nuk flisni apo nuk kuptoni frengjisht, keni te drejte te asistoheni falas nga nje perkthyes gjate degjimeve e ballafaqimeve tuaja dhe per te komunikuar me avokatin tuaj.

### **Te konsultoni disa nga elementet e dosjes suaj**

Me kerkesen tuaj apo te avokatit tuaj, ju mund te kerkoni te konsultoni proces-verbalin apo proces-verbalet e degjimeve dhe ballafaqimeve tuaja.

### **Te perfitoni nga keshilla juridike**

Ju keni mundesine te perfitoni, ne rast nevojje falas, nga keshilla juridike ne nje strukture ndihme juridike, koordinatat e se ciles ju komunikohen ne nje dokument shtese.